



# TransEducation

## Emri:

„TransEducation“ është emri i shoqatës, dhe ka për qëllim të shprehë: „transferimin e edukimit“ apo „Përçimin e edukimit nga një vend në një tjetër“, referuar specifikisht Islamit.

## Përshkrim i shkurtër:

Përmes formimit të referuar ne islam, shoqata TransEducation do që të reduktojë pasigurinë e shoqërisë (në aspektin e fesë islame) dhe t'i sqarojë ato nëpërmjet islamit. Përpjekjet kryesore janë të fokusuara në çështjen aktuale të radikalizimit të të rinjve. Shoqata është një mjet parandalues kundër rekrutimit të të rinjve në zonën e luftës së islamistëve. Kjo bëhet e mundur falë nënprojekteve „islamic discussion club“ dhe „islamic glasses“ të shoqatës TransEducation. Përveç kësaj, TransEducation shërben si një platformë prezantuese e rezultateve të hulumtimeve aktuale të Universiteteve dhe departamenteve të Shkencave të Aplikuara, duke iu mundësuar atyre që të marrin pjesë në mënyrë aktive nëpër Workshop-e.

## Arsyetimi i Projektit:

Në ditët e sotme, njerëzit në mbarë botën ballafaqohen me një imazh shumë negativ të islamit. Edhe në Zvicër, si pasojë e përpjekjes së mediave dhe disa partive politike për të bërë emër, shpesh Islami paraqitet i lidhur me frikë dhe panik, përkatësisht me terror. Edhe pse ky keqpërdorim i Islamit bëhet nga një grup i vogël, radikal e dhunues, veprimet e këtij të fundit ndikojnë tek i gjithë komuniteti fetar. Në Zvicër, muslimanët dhe muslimanet përbëjnë një pakicë prej 5%, gjë e cila shton rrezikun e përjashtimit të këtij minoriteti nga shoqëria lokale. Ky i fundit pasqyrohet jo vetëm në votimin e popullit zvicerian, por edhe kur bëhet fjalë për të fituar një vend në shkollën profesionale (gj. Ausbildung).

## Qëllimet e Shoqatës:

- Edukimi dhe Preventim në fushën e Islamit ( të rinj muslimanë e muslimane, si dhe jomuslimanë e jomuslimane) - por edhe institucione, (si për shembull: shkollat ose institucionet e punës sociale)
- Pikë referimi për shkëmbimin e informacionit dhe diskutimet rreth Islamit
- Ndërlidhje në politikë (në çështjet dhe kërkesat e lidhura me islamin)
- Kundërvënie ndaj islamofobisë në rritje në shoqërinë civile
- Tematizimi i diskutimeve kritike në lidhje me islamin (ndër të tjera, debati mes muslimanëve)
- Kontribut i vazhdueshëm në hulumtime shkencore

## Objektivat e synuara:

- Identifikim i mangësive në edukim dhe reduktim i frikës, nëpërmjet projekteve tona
- Pjesëmarrje në tema që ngjallin interes dhe janë në fokus të grupeve të caktuara
- Lojëra me ndihmën e mediave (të reja), në veçanti për të rinjtë
- Interpretim i temave kritike ndaj grupeve të caktuara (për shembull: Kriza e Islamit)
- Tërheqje e vëmendjes për ankesat dhe luftën kundër rritjes së islamofobisë në politikë

## Output/ Produktet e Projektit:

- **Projekti „islamic discussion club“:** Workshop-e për të rinjtë (nga klasa e 6-të), muslimanët dhe jomuslimanët (të interesuar në diskutim). Për shembull: nëpër shkolla, Takime për të rinjë, Xhamia, etj.
- **Projekti „islamic glasses“/ në bashkëpunim me TransCommunication:** Workshop-e për profesionistë të fushave të ndryshme, Institucionet, Shkollat, Administratat shtetërore, të cilat janë në kontakt të vazhdueshëm me muslimanët.

- Evente / Konferenca dhe ligjerata mbi çështjet aktuale të lidhura me Islamin (për shembull: në çështje specifike, i konflikti Sirian, etj.)

→ Për më shumë informacion rreth projekteve tona [www.transeducation.ch](http://www.transeducation.ch)

### **Kohëzgjatja e projektit aktual:**

- Projekti i përgjithshëm Trans Education do të zgjasë nga shtatori 2016 deri (afërsisht) në shtator 2019.
- Në workshop-e rekomandojmë data individuale (për shembull: „islamic discussion club“ do të ketë të paktën 6 seminare) – ne jemi fleksibël me oraret.

### **Vlerësimi:**

- Vlerësim sistematik me ose pa grupet e Projektit.
- Metoda vlerësimi të punës sociale dhe të animacionit socio-kulturorë
- Raport i ndërmjetëm për projektet aktuale (me kërkesë)

### **Kush jemi ne:**

Ne jemi një grup që përbëhet nga muslimanë dhe muslimane të moshës së re dhe të specializuar në Punën Sociale si dhe në shkencat e Edukimit dhe të Politikës. Ne të gjithë kemi një prejardhje migrimi dhe jetojmë në Zvicër.

- **Tugba Schussmann**, Animatore socio-kulturore, Universiteti i Shkencave të Aplikuara (gj. Fachhochschule), Punonjëse e Rinisë, Menaxhere e përgjithshme në shoqatën TransEducation, Menaxhuese e Projektit „islamic discussion club“.
- **Dr. Yahya Hassan Bajwa**, Anëtar i asamblesë së qytetit Baden, Ish-parlamentar i Kantonit Aargau, Ligjërues, Dr. Filozof, Menaxhues i Projektit „islamic glasses“ / TransCommunication.
- **Nadia Sarfraz**, Bachelor i Artëve (me lavdërim: Hons), Marrëdhënie Ndërkombëtare
- **Mandy Abou Shoak**, Animatore socio-kulturore, Universiteti i Shkencave të Aplikuara (gj. Fachhochschule), Punonjëse e Rinisë.
- **Sara Mia**, Magjister, Mesuese

Ju lutem na kontaktoni, nëse keni ndonjë pyetje.